

buletiniinfo

Buletin informativ mjuor
Qershori, 2022



SHËNOHET 24 QERSHORI DITA E EGJIPTIANËVE



Mbahët Kuvendi i VIII-të
zgjedhor i IRDK-së



Zbulohet pllaka
përkuqtimore e dëshmorin
Xhevdet Hoti



Të bëhet ndarja e drejtë
e fillestareve nëpër
paralele

32 VITE NGA 24 QERSHORI I VITIT 1990

24 Qershori i vitit 1990, një Kuvend i "njerëzve tanë", në Ohër, i pa parë më herët për nga qëllimi që kishte, shënon një pikënisje e rrugëtimit që na gjënë këtu ku jemi sot. Për shkak të zhvillimeve të vrullshme të viteve '90, rënia e sistemit komunist në shtetet e bllokut komunist, e shoqëruar me luftëra në shtetin e dikurshëm të Jugosllavisë, nisma në Ohër me 24 Qershori ishte e vështirë të bashkonte popullin e shpërndarë në Maqedoni, Shqipëri, Kosovë, Serbi e Mal të Zi. Formalizimi i identitetit të veçantë etnik, i ruajtur në ndërgjegjen e popullit përgjatë historisë, nuk ishte i lehtë sepse kjo nuk mund të kalohej pa duart e politikës. Me arsyetimin se "këta" ishin me "ata", në vitin 1999 kemi plasaritjen më të madhe, ku identiteti Egjiptian është kontestuar nga vetvetja të cilët morën rrugën e identitetit territorialisht të veçuar dhe të njojur si ashkali, të cilët sikur grupet tjera etnike u formalizuan në Kosovë. Zyrtarizimi i dy termave: Egjiptian dhe Ashkali, për të njëjtin grupim etnik ka dobësuar qëllimin e nismës së Kuvendit në Ohër.

Në 32 vjetorin e Kuvendit të parë të organizuar nga intelektualët e kohës, siç ishe Nazmi Arifi dhe intelektual tjerë, grupe të caktuara nga radhët tona, identitetin tonë etnik ende i vendosin në pikëpyetje. Të formalizuar në Kushtetutën e Kosovës si Egjiptian dhe Ashkali, që në opinionin publik më së shpeshti funksionon edhe bashkë me Romët, pra si Rom, Ashkali dhe Egjiptian, sot populli ynë vazhdon të frymoj politikisht përmes partive politike. Për shkak të kurtheve që i kemi ngritë vetvetes, për interesa të ngushta grupore e politike, identitetin tonë etnik të tjerët e kërkojnë brenda korpusit rom. Inatet e grupacioneve që e vlerësojnë veten e tyre si baba të kombit, në vazhdimësi, e kanë penguar dialogun për të bërë zgjidhje në interes të unifikimit rrith etnisë.

Në zgjedhjet e fundit parlamentare në Kosovë,

të mbajtura në vitin 2021, kanë garuar pesë parti politike nga radhët tona: Egjiptian dhe Ashkali. Gara prej pesë partive nga një elektorat relativisht i vogël ka politizuar popullatën tonë. Problemet me të cilat ballafaqohet një pjesë e komunitetit, siç është varfëria ekstreme, janë të vështira për të bërë zgjidhje nga përfaqësuesit politik. Përderisa në Kosovë ka zhvillim të ngadalshëm ekonomik dhe demokratik, zgjidhja e varfërisë ekstreme mund të vije në konsideratë nëse Qeveria ka plane të veçanta sektorale për të zbutur varfërinë. Ndërhyrjet e Qeverisë me projekte të vogla konkrete janë të dobishme për grupin që ka qenë në fokus, mirëpo shtresa e komunitetit që jetojnë në margjina të shoqërisë, vështirë që do të ketë ndryshim pozitiv. Prandaj lufta politike në mes subjekteve politike të komunitetit nuk është shumë e arsyeshme sepse nuk është gjithçka në dorën e tyre për të ofruar zgjidhje. Jo pse partitë tona nuk e dëshirojnë zgjidhjen e problemeve por fuqia e tyre politike nuk është në proporcion me fuqinë për të shtyerë në marrje të vendime të mëdha.

Në ditën kur festojmë 32 vjetorin e fillimit të organizimit tonë publik, është tepër e rëndësishme që pjesëmarrja jonë në institucionet shtetërore të Kosovës, si në Polici, Dogana, Ushtrinë e Kosovës, Gjygüesi, Prokurori dhe Administratë shtetërore të jetë më e madhe. Qeveria të luaj rol kryesor në mos braktisja e shkollimit fillor dhe të mesëm, dhe shtresat më të varfëra të ndihmohen nga fondet publike në mënyrë që të përballohen vështirësitë ekzistenciale. Të provohet zhvillimi i dialogut të brendshëm në mes partive politike dhe grupimeve me baza etnike Egjiptian dhe Ashkali për t'i bashkuar dhe koordinuar idetë në funksion të përballimit me sfidat e varfërisë dhe identitetin etnik të pa unifikuar.

Fazli Stollaj



MBAHET MBLEDHJA E VIII-TË E KUVENDIT ZGJEDHOR TË IRDK-SË

Me datën 30.06.2022 në Pejë, është mbajtur Mbledhja e Kuvendit të VIII-të zgjedhor e IRDK-së. Pas intonimit të himnit të Kosovës, kryesuesi i Kuvendit Mergim Neziraj ka mbajt një fjalë hyrëse. Ai theksoi se në këto 21 vite të funksionimit të IRDK-së, kemi kaluar nëpër situata të ndryshme ku me idetë dhe veprimet tona kemi ndërtuar një vizion për komunitetin tonë. Në këto vite të funksionimit të IRDK-së u angazhuan të ri e të reja, aktivist nga të gjitha moshat e nga të gjitha komunat e Kosovës, veprimtarë të diasporës nga Gjermania e Zvicra. Për këto 21 vite në IRDK janë angazhuar intelektual e patriot. Disa prej tyre sot nuk janë në mesin tonë. Sot në mesin tonë nuk është Ibish Bajrami, Imer Alija, Ramiz Zizaku, të cilët u nderuan me një minutë heshtje. Kryetari i IRDK-së, ministri Elbert Krasniqi ka përkujtuar vështirësitë, sfidat dhe të arriturat e IRDK-së për katër vitet e kaluara. Ai ka theksuar se gjatë këtyre viteve kemi bërë punë të mira por edhe kemi bërë edhe gabime, jemi të njëjtë sikur para katër viteve por ka edhe ndryshime. Ai ka përmendur sfidat dhe vështirësitë me të cilat sot ballafaqohet komuniteti Egjiptian dhe faktin se jemi pjesë e Qeverisë dhe me të gjitha mundësitë tona po bëjmë përpjekje për të ndihmuar komunitetin.

Zëvendës kryetari i IRDK-së, deputeti Fridon Lala ka theksuar se në IRDK erdhi para dy viteve dhe kemi fituar dy palë zgjedhje. Strukturat organizative të IRDK-së duhet të funksionojnë më mirë ka theksuar zëvendëskryetari i IRDK-së Fridon Lala.



Elbert Krasniqi



Fridon Lala

Kuvendi zgjedhor i IRDK-së ka diskutuar dhe ka miratuar ndryshime statutore të cilat janë vlerësuar që gjatë periudhës së kaluar kanë qenë të pa nevojshme ose kanë shkaktuar vështirësi në funksionimin e organeve të IRDK-së.

Kuvendi zgjedhor i IRDK-së ka paraqitur vetëm një propozim për kryetar të IRDK-së dhe në mënyrë unanim Kryetar i IRDK-së është zgjedhur Elbert Krasniqi.

Në punimet e Kuvendit zgjedhor është miratuar deklarata politike me këtë përbajtje:

“ Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, partia e parë politike nga radhët e komunitetit Egjiptian në Kosovë, pas 21 viteve të veprimtarisë, vazhdon të angazhohet me mjete politike për avancimin e pozitës së Egjiptianëve në shoqërinë e Kosovës.

Ne u jemi mirënjoës themeluesve të IRDK-së, të cilët në fillet e funksionimit të IRDK-së kishin përmision mbrojtjen e qenies tonë.

Jemi mirënjoës të gjithë atyre që u mblodhën rreth IRDK-së, në veçanti diasporën tonë për kontributin e tyre për organizimin politik të komunitetit.

Mirënjoës për aktivistët tanë që për këto vite punuan për të ndihmuar pjesëtarët e Egjiptianëve në Kosovë për mirëqenie, arsimim e barazi me të tjerët.

Mbi bazamentin e ndërtuar të IRDK-së në 21 vitet e funksionimit, IRDK në katër vitet e ardhshme do të jetë e përkushtuar për:

- Forcimin e strukturave organizative të IRDK në funksion të transparencës, efikasitetit dhe funksionimit demokratik.

- Pasurimin e programit politik të IRDK-së në fryshtën socialdemokrate.

- Partneritet me partitë socialdemokrate me qëllim të shkëmbimit të përvojave.

- Përfaqësimin e komunitetit në institucionet e Kosovës me qëllim të barazisë sociale, rritje të nivelit të arsimimit, punësimit dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

- Bashkëpunimin me partitë politike dhe shoqërinë civile të komunitetit Egjiptian në Shqipëri, Maqedoni dhe vende tjera të rajonit”.



NË PRAG TË 24 QERSHORIT, KRYEMINISTRI I KOSOVËS TAKOHET ME PËRFAQËSUESIT TË KOMUNITETIT EGJIPTIAN

Me daën 21 Qershor, në prag të 24 Qershorit, Ditës Memoriale të Komunitetit Egjiptian në Kosovë, Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti ka organizuar tryezë diskutimi lidhur me gjendjen e komunitetit Egjiptian.

Në tryezën e përbashkët në të cilën morën pjesë Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, zëvendëskryeministrja e Qeverisë së Republikës së Kosovës, znj. Emilia Redzepi, Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, z.Elbert Krasniqi, deputeti i Kuvendit të Republikës, z.Fridon Lala, këshilltarja e kryeministrat znj.Elizabeth Gowning, përfaqësues politikë, përfaqësues të institucioneve e të shoqërisë civile si dhe shërbyes civil.

Kryeministri i Kosovës theksoi se ne kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë me komunitetin gjatë vittit, i cili për nga bashkëpunimi politik me siguri ishte në nivel të shkëlqyeshëm, por edhe me komunitetin përmes Zyrës për Çështje të Komuniteteve brenda Zyrës së Kryeministrat, ku natyrisht që mund të bëjmë shumë punë të mira në të ardhmen, tha kryeministri në hapje të tryezës së organizuar nga Zyra për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrat.

Duke i falënderuar për kontributin shumë të vlefshëm në ndërtimin e Kosovës, kryeministri Kurti shprehu mirënjojje edhe për gatishmërinë e përfaqësuesve të komunitetit për të vazhduar bashkëpunimin me Zyrën e Kryeministrat.

Kryeministri ka përmendur realizimin e kuotës për punësim në institucione, bursat për 100 nxënës për studime në fakultetin e Edukimit, 500 bursa për student.

Në këtë takim kanë diskutuar edhe zëvendëskryeministrja e Kosovën Emilia Redzepi, Ministri i MAPL Elbert Krasniqi, deputeti Fridon Lala, të cilët kanë përmendur hapat konkret të Qeverisë, problemet që e preokupojnë komunitetin si dhe pengesat për zyrtarizimin e 24 Qershorit në Ligjin për festat zyrtare. Kanë diskutuar edhe ërfaqësues të shoqërisë civile Mirjeta Qehaja, Gazmend Qyqalla, dhe shërbyesit civil si shefi i Zyrës për komunitete në Rahovec Lendrit Qeli, shefi i Zyrës për komunitete në Gjakovë Armend Behluli të cilët kanë shprehur konsiderata për Qeverinë e cila është e gatshme që të dëgjoj dhe kanë shprehur opinionet e tyre për problemet aktuale siç është banimi, varfëria, papunësia dhe probleme tjera të komunitetit Egjiptian në Kosovë.



ZBULOHET PLAKA PËRKUJTIMORE PËR DËSHMORIN XHEVDET HOTI

Për nder të 24 Qershorit -Ditës së komunitetit egjiptian, me datën 23 Qershor, Ministri i Mbrojtës së Republikës së Kosovës, z.Armend Meha, së bashku me ushtarakë të FSK-së, përfaqësuesit nga komuniteti Egjiptian dhe banorët e fshatit Jabllanicë të Gjakovës, bashk me familjarë, Ministrin e MAPL-së, Elbert Krasniqi, deputetin e Parlamentit të Kosovës nga radhët e IRDK-së, z.Fridon Lala, Kryetarin e degës së IRDK-së në Gjakovë, Skender Qorri, zbuluan pllakën përkujtimore për Dëshmorin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Xhevdet Hotin, dëshmor ky nga komuniteti Egjiptian i Kosovës.

Misioni i luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës fitoi besimin e plotë edhe të gjitha komuniteteve liridashëse të vendit tonë, ka theksuar Ministri i Mbrojtjes, z.Armend Meha.

Republika e Kosovës, institucionet e saj dhe gjithë populli liridashës do të nderoj dhe respektoj të gjithë dëshmorët, martirët, luftëtarët dhe veprimtarët nga të gjitha komunitetet jo-shumicë që qëndruan përkrahë shqiptarëve në kauzën e përpjekjeve dhe luftës për lirinë dhe pavarësinë e vendit tonë, ka theksuar në vazhdim Ministri Mehaj.

Forca e Sigurisë së Kosovës në radhët e saj, përvëç ushtarakëve nga komunitetet tjera jo-shumicë, ka në radhët e saj edhe ushtarakët nga komuniteti egjiptian që shërbijnë me nder, dinjitet dhe profesionalizëm në të mirën e vendit dhe qytetarëve pa dallim.

I përjetshëm kujtimi, nderimi dhe lavdia për Dëshmorin Xhevdet Hoti.

ZBULOHET PLLAKA PËRKUJTIMORE E DËSHMORIT TË UÇK-SË XHEVDET HOTI





DEPUTETI FRIDON LALA, PROTESTON NË PARLAMENT PËR SHKAK TË MOS ZYRTARIZIMIN TË 24 QERSHORIT

Pasi që jemi në prag të Ditës memorialë të komunitetit Egjiptian, 24 Qershori, dhe kjo seancë përkon më së afërti me atë datë, si përfaqësues i komunitetit Egjiptian në Parlamentin e Kosovës, shfrytëzoj rastin që të gjithë pjesëtarëve të komunitetit Egjiptian në Kosovë dhe më gjerë t'ju uroj Ditën Memoriale, 24 Qershori. Kjo datë ngërthen ndër veti sakrifica të shumta të aktivisteve, burra e gra të këtij komuniteti, të cilët përvite të tëra kanë ruajtur me fanatizëm identitetin kombëtar dhe këto sakrifica u finalizuan në formën e parë të organizimit politik me 24 Qershori të vitit 1990, në Ohër të Maqedonisë së Veriut.

Fatkeqësish edhe këtë vit komuniteti Egjiptian po e manifeston ditën memorialë të tyre pa plotësim ndryshimin e Ligjit për festat zyrtare, Ligj ky i cili për momentin e diskriminon të vetmin si kategori kushtetuese, komunitetin Egjiptian, duke mos njojur ditën memorialë të tyre ashtu siç i njeh kategoritë tjera kushtetuese apo grupet tjera etnike. Për të disatën herë e kemi prurë në Kuvend mirëpo fatkeqësish nuk kemi pas konsensus politik që të tejkalojmë dhe kolegët deputet tashmë janë të njoftuar rrëth pengesave, mirëpo përhire të opinionit të gjerë që vazhdojnë të kenë hamendje se pse një gjë e tillë nuk po ndodhë, nëse ka pengesa nga mazhuranca parlamentare apo ndonjë grup i caktuar parlamentar. Dëshiroj që të njoftoj që kur e kemi nisë këtë nismë legjislative për të plotësuar këtë ligj, kur e kemi diskutuar në komisionin përkatës, fatmirësisht kemi marrë përkrahje nga të gjitha grupet parlamentare, duke nisur nga grupei parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, po ashtu nga grupet parlamentare të PDK-së, LDK-së e AAK-së. Në këtë rast dëshiroj që ti përshëndes përmbështetjen që na kanë jap. Mirëpo duke i marrë parasysh specifikat e këtij Ligji, ku nevojiten 2/3 e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë, vullneti i grupit multietnik nuk po mjafton, në këtë rast na duhet përkrahja edhe e deputeteve të Listës Serbe dhe një gjë e tillë nuk po ndodh që disa seanca. Me të vërtetë është një gjë e pa kuptimit përmua se si një kategori kushtetuese e cila jo rrallë herë është e privilegjuar nga të gjithë ne, po e shfrytëzon një të drejt kushtetuese por t'ia mohuar një grupei tjeter një të drejt kushtetuese siç është festa zyrtare, apo dita memorialë e këtij komuniteti, njëjtë siç e njeh përgrupet tjera. Sidoqoftë ne nuk do të ndalim së kërkuar të drejtën tonë kushtetuese dhe prapë ju bëjë thirrje deputetëve nga Lista serbe që të gjemë një konsensus për shkak se kjo festë është tepër e rëndësishme për komunitetin Egjiptian dhe ne si të gjithë të tjerët dëshirojmë që ta kemi të zyrtarizuar Ditën tonë Memoriale, si të gjithë grupet tjera. Edhe një herë shfrytëzoj rastin që të gjithë pjesëtarëve të komunitetit Egjiptian t'ju uroj festën me shpresën që vitin e ardhshëm do të festojmë me një mirëqenie më të mirë.



NË DITËN E KOMUNITETIT EGJIPTIAN, KRYEMINISTRI ALBIN KURTI TAKOI DISA PËRFAQËSUES TË KOMUNITETIT EGJITPIAN

Me rastin e 24 Qershorit, Ditën e Egjiptianëve në Kosovë, disa përfaqësues nga komuniteti janë pritur nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti.

Në këtë takim ishte edhe kryetari i IRDK-së Elbert Krasniqi i cili është edhe Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal, Xhevdet Neziraj, Fazli Stollaj, Hysnije Berisha, Arjeta Shala, Aida Morina dhe Valmir Rama. Në këtë takim u bisedua për pozitën e komunitetit egjiptian në shoqëri.

Duke vlerësuar bashkëpunimin shumë të mirë të deritanishëm, Kryeministri Kurti theksoi angazhimin e vazhdueshëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përmirësimin e gjendjes socio-ekonomike të këtij komuniteti.

Kryeministri potencoi nismat e Qeverisë që do të ndikojnë në rritjen e mundësive për edukim dhe punësim të komunitetit egjiptian. Ai veçoi bursat për studime në Fakultet të Edukimit dhe në drejtime të tjera të studimeve, si dhe hapin e rëndësishëm drejt realizimit të kuotës për punësim në institucionet, vendimin për krijimin e ekipit ndërinstitucional për punësimin e komuniteteve.



ORGANIZOHET TURNIR NË FUTBOLL TË VOGËL NË ISTOG ME RASTIN E 24 QERSHORIT

Me datën 19 Qershor, për ndërë të "24 Qershoret", Ditës së komunitetit Egiptian, dega e IRDK-së në Istog si çdo vit më parë edhe këtë vit ka organizuar turnirin memorial të futbollit. Turniri në futboll të vogël është zhvilluar në Palestrën e Sporteve në Istog.

Në këtë turnir kishte një numër të konsiderueshëm të pjesëmarrësve.

Ne finale të këtij turneu ishin ekipe "TIGRAT" dhe ekipi "FASADERAT", ku zhvilluan një lojë te shkëlqyeshme.



Ekipi "TIGRAT" zuri vendin e parë ndërsa Ekipi "FASADERAT" zuri vendin e dytë dhe u shpërblyen me disa shpërblime simbolike.

Kryetari i Degës së IRDK-së në Istog, Lush Çukaj, i falenderuar të gjithë pjesëmarrësit e këtij turneu dhe të gjithë ata që u angazhuar në mbarëvajtjen e këtij turneu. Në këtë rast Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Istogut ka mundësuar shfrytëzimin e Palestrës së Sporteve në Istog.



PËR 24 QERSHOR, TRYEZË DISKUTIMI NË GJAKOVË

Me datën 24 Qershor, në Gjakovë, u shënua 24 Qershori, Dita Nacionale e Komunitetit Egjiptian, me një tryezë diskutimi e organizuar nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, ku morën pjesë Kryetari i Gjakovës Ardian Gjini, Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Fridon Lala, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete në Komunën e Gjakovës, Ergit Qeli dhe Udhëheqësi i ZKKK-së, Armend Behluli. Gjatë këtij takimi Kryetari Gjini mes tjerash tha se po punohet me një orientim strategjik, drejtë përmirësimit të kushteve sociale për komunitetet pakicë.

Ndërsa Deputeti Lala tha se për 20 vite janë bërë ndryshime në aspektin e përmirësimit të mirëqenies sociale te komunitetit egjiptian, por se mbetet akoma shumë punë për tu bërë në këtë drejtim.

Gjatë takimit u ndanë mirënjohje për disa prej të pranishmeve, në shenjë falënderimi për kontributin që japid në fusha të ndryshme.



Momentet e ndarjës së mirënjoyeve nga komuna e Gjakovës në Ditën e Egjiptianve, në shenjë falënderimi për kontributin që japid në fusha të ndryshme.

TË BËHET NDARJA E DREJTË E FILLESTARËVE NËPËR PARALELE



Musli Ferizaj

Me rastin e regjistrimit të fillestarëve në shkollat tona fillore , e sidomos në shkollat e qyteteve, bëhet zhurmë e madhe.

Disa prindër , në bazë të paragjykimeve të tyre nxitojnë të zgjedhin mësuesin apo mësuesen më të mirë për fëmiun e tyre. Ata në këtë rast mendojnë vetëm për interesin personal e fare për atë kolektiv, gjë që medoemos ndikimi është më përmasa negative.

Realizimi i interesit kolektiv, përparimi masovik i fëmijëve tanë mund të bëhet parasë gjithash me ndarjen e drejtë të fillestarëve nëpër paralele. Këtë ndarje medoemos duhet besuar vetëm Komisioni për regjistrimin e fillestarëve, i cili punon vazhdimisht nën udhëheqjen e pedagogut dhe drejtorit të

shkollës (pasi që fatkeqësisht në shkollat tona s'ka shërbim komplet pedagogjik).

Madje, disa prindër janë aq këmbëngulës në zgjedhjen e mësuesit për fëmijët e tyre sa që bëjnë edhe intervenime (që janë fare të paarsyeshme) duke menduar kështu se ne këtë mënyrë kanë bërë zgjidhje përfundimtare të çështjes së arsimimit dhe edukimit të fëmijëve të tyre, dhe pas këtij rasti kurrë më nuk paraqiten në shkollë për të parë se si i është përshtatur fëmiu "zgjidhjes fatlume" që i ka bërë prindi i tij.

Nga ana tjeter disa mësues për t'i dalë zëri si "mësues të mirë " dhe në anën tjeter për të ia lehtësuar punën vetes zgjedhin nxënësit "më të mirë ", zakonisht nga familjet intekuale dhe të pasura ekonomikisht.

Kështu ata përveç regjistrat zyrtar formojnë edhe një regjistër personal privat dhe ne këtë mënyrë bishtërojnë ndarjen e drejtë të fillestarëve në paralele.

Ndodhë shpesh që një mësues të grumbullojë një numër të madhë nxënësish pranë vetes jashtë normës juridike e pedagogjike, kurse paralelet tjera të mbisin me numër shumë më të vogël nxënësish. Çka pastaj? Pas disa javësh të fillimit të viti shkollor, mësuesi i cili ka grumbulluar shumë nxënës në paralelen e tij fillon të bëj zgjedhjen e tyre, ndërkaq të tjerët "tepricë" duke qarë i dërgon në paralelet tjera. Atëherë çka mund të themi pastaj për efektin psikologjik dhe pedagogjik tek fëmijët?! Në bazë të praktikës pedagogjike shkollore është e domosdoshme të bëhet ndarja e fillestarëve me kohë dhe në mënyrë sa më të drejtë.

Me nxënës të zgjedhur është lehtë të punohet nga se ata rrjedhin nga familjet intelektuale (që kanë parapërgatitje shkollore) dhe familje të pasura (të cilat ua mundësojnë shkollimin e rregullt fëmijëve të tyre duke i furnizuar me tekste

shkollore, veshmbathje dhe transport udhëtimi). Por si të veprohet me fëmijët e familjeve të komuniteteve, familjeve jo intelektuale, e të varfëra?

Nuk duhet harruar se edhe nga këto familje kanë dalur e do të dalin nxënës shumë të mirë në sjellje e mësime, andaj klasifikimet e tillë veç sa e rëndojnë praktikën pedagogjike shkollore dhe e pengojnë në masë të madhe procesin mësimor në shkollat tona.

Detyrë e çdo mësuesi, por edhe prindi është që fëmijët t'i trajtojmë njësoj, t'i duam njësoj dhe të kujdesemi për të gjithë njësoj. Pra është e domosdoshme që fëmijët e klasave të para t'i ndajmë në mënyrë sa më të drejtë nëpër paralele duke pasur parasysh me rastin e ndarjeve strukturën intelektuale, gjinore dhe socio-ekonomike. Në këtë mënyrë do të kemi më shumë nxënës të mirë dhe më shumë të mësues të mirë.

Kjo është në interesin tonë të përbashkët.

Musli Ferizaj, pedagog

MANIFESTIMI PËRMBYLLËS I 24 QERSHORIT NGA DEGA E IRDK-së NË GJAKOVË



MANIFESTIMI PËRMBYLLËS I 24 QERSHORIT NGA DEGA E IRDK-së NË GJAKOVË





PIKËPAMJA E POPUJVE PËRRETH LIDHUR ME EGJIPTIANËT

MARCEL COURTHIADE

Vihet re që, nga Bullgaria në Shqipëri, egjiptasët e Ballkanit janë të famshëm për megalomaninë e tyre meqënëse në bullgarisht thuhet "Agypti, kur u bë mbret, fillimisht vari të atin", në shqip Kur u bë jevgu pashë, vrau babën e vet madje edhe në rromisht Kana avilo o Rlia bej, mudarda pe dades "id". Thuhet gjithashtu për ta që nuk dijnë të bëjnë ekonomi shtëpiake: Kana o Rlia pelo k-o khil, makhla pe pele . "Kur egjiptiani ra në gjalpë, u lye nga poshtë". Një karakteristikë tjeter qe populli i ngjit atyre është frika: "zemër Agjupi" do të thotë pulë e lagur në Bullgari dhe shqiptarët pretendojnë që nëna evgjite këshillonte djalin para se të shkonte në luftë Vre kho, të keqen nona, bëni dredha plumbit, mçifu mas gaxhoit ! Një anektodë shpreh të njëtin stereotip duke shpjeguar origjinën e shprehjes se çuditshme "ha zemrën e bardhë te jevgut": Ky kishte shumë frikë nga arinjtë. Një natë ngritet, del e ecën pa vënë re, nën një sitë që e godet duke u ngritur. I bindur se ishte një këmbë ariu, pati kohë vetëm të thotë "ha tani ari, zemrën e bardhë të jevgut" para se të binte në tokë i vdekur nga frika.

Sigurisht të gjithë popujt, dhe veçanërisht në Ballkan, kanë anekdota të tillë për popujt përreth, të cilët i marrin me dëshirë për llogari te tyre. Ajo çka duhet, nuk është që të censurohet ky humor popullor, se ai i jep përditshmes një pikant që rromët dhe egjiptianet e shijojnë si në tavolinë ashtu edhe në jetë, por është e rëndësishme që përhapja e këtyre imazheve të shoqërohet me një vullnet pedagogjik që i vendos ato në kuadrin e tyre natyror: një bisedë e thjeshtuar e jetës fshatarake së kaluar, limitet e së cilës duhen njobur gjithmonë. Përkundrazi, këto imazhe mund të na sjellin një bazë të shkëlqyeshme për të luftuar, veçanërisht duke i përqeshur, të gjitha stereotipet që mbeten të lidhura me identitetin ballkano - egjiptian.

Përbuzje dhe persekutim kundër evgjitéve dhe Ashkalive. Shqipëria e paraluftës nuk ishte aspak e dashur me të mjeruarit, mes të cilëve numëroheshin shumica e evgjitéve "të dukshëm", por nuk mund te flitet për persekutim në kuptimin e mirëfilltë të fjalës.

Edhe në Jugosllavi, Ashkalitë nuk ishin trajtuar keq, vetëm te lënë në punën e tyre, si pjesa më e madhe qytetarëve. Pas vdekjes së Titos, gjendja ndryshoi rrënjesisht, sepse Ashkalitë filluan pak nga pak të jenë shënjestra e serbëve racistë, për faktin se ata shiheshin si "ciganë shqiptarë" - dy damka të rënda bashkë. Por me ndryshimin e situatës në 1999, disa ekstremistë shqiptarë kosovarë, partizanë të pastrimit etnik, filluan të ngacmojnë ashkalitë, në të njëjtën mënyrë si rromët, për arsyen e thjeshtë se injorantët i ngatërojnë me termin e përbashkët magjup, dhe ektremistet luajnë rolin e injorantëve për të justifikuar abuzimet e tyre. Në këtë mënyrë në një popullate që ishte rreth 60 000 shpirtra në fillim të vitit 1999 (sidomos në Pejë/ Pec, Gjakovë/ Đakovica, Prizren, Prishtinë dhe përreth, Ferizaj/Uroševac), vetëm 20 000 ishin në Dardani një vit më vonë, ndërkoq që vetëm 2 800 shtëpi nga 8 500 gjithsej i rezistuan shkatërrimit. Disa vrasje kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe, më e njohura mbetet ajo e Skenderajt ku u vranë në natën e 8 -9 Nëntorit 2000 katër Ashkali që UNHCR-i sapo i kishte bindur të kthehen në shtëpitë e tyre. Ky barbarizëm racist nuk ndaloj përgjatë gjithë vitit 2000, në përbuzjen absolute të kontributit te ashkalive në çështjen shqiptare. Shihet mire se pika e përbashket midis rromëve dhe ashkalive nuk është as kombëtare, as kulturore, por të jene viktima të përsekutimeve të tilla. Ne fakt problemi qendorr është i lidhur me përbuzjen dhe me mungesën e besimit që anëtarët e këtyre grupeve ndeshin çdo ditë. Është arsyaja për të cilën do të ishte utopike, madje hipokrite, t'i trajtosh brenda ditës si qytetarët e tjerë. Do të ishte sikur të mohonim në të njëjtën kohë këtë përbuzje të dhimbshme dhe identitetin e tyre historik, ndërkoq që është e rëndësishme që ballkano-egyptianeve t'i njihet një status minoriteti historik dhe ngritja në vlerë e identitetit të tyre duke e bërë më të njohur, dhe veçanërisht me kërkime dhe me arsim, që të luftohet moskuptimi me të cilin ata ndeshen. Disa shoqata propozuan hyrjen e një lënde të Egjiptit të lashtë si lëndë fakultative për fëmijët e këtij grapi, çka që do të kishte një vlerë simbolike të rivlerësimit kulturor dhe të hapjes së shpirtit drejt horizonteve më klasike të qytetërimit të lashtë të Mesdheut. Në realitet, aplikimi i këtij propozimi ndeshet me pamjaftueshmërine e kushteve të shkollimit nga e cila vuajnë shumë fëmijë ballkano-egyptianë.

Ndryshimet e këtyre viteve të fundit kanë qenë një rast për Ashkalitë për t'u afirmuar, ose si të tillë përmes përbajturit, ose si egypitanë përmes entuziastët, të dy termat duke shprehur përfundimisht dy pikpamje, njëra lokale dhe traditore, dhe tjetra intelektuale dhe e politizuar, të të njëjtë identitet. Janë konflikte personale të mëpasshme midis grupeve ato qe bënë që këto emërtime të përdoren si emërtime përmes grupe gjoja të ndryshëm. Duhet vënë re se Askalitë e Ferizajt/Uroševac kanë arritur më mirë afirmimin e tyre, me disa intelektualë të rinj të vendosur të mbrojnë njëherazi identitetin e tyre dhe njohjen e tyre si komb nga autoritetet shqiptare - çka nuk kaloi pa sulme të shunshme të rromëve proserbë jashtë vendit (serbi, Maqedoni, diaspora në Gjermani etj...). Megjithatë, ekuilibri etnik në Ballkan mund të arrihet vetëm falë zbatimit të së drejtës së tyre përmes vetëidentifikuar lirisht dhe jo duke i përfshirë ata artificialisht në identitetin rrom.

Edhe pse elementet e ndryshëm të paraqitur këtu nuk janë diçka e re apo e panjohur, atrimi dhe bashkërendimi i tyre përbën njëfarë risie që pa dyshim do të ndeshet për vite akoma me kokëfortësinë e atyre që e kanë të vështirë të ndryshojnë shikimin e vet mbi atë me të cilën janë mësuar, sidomos me vizionin e padallimit të një bashkësie heteroklite “magjupësh” (ose gjetkë “ciganësh” etj.), kategori kjo përbuzëse që jo vetëm mbulon shumë grupe me identitetë të ndryshme por e cila mohon identitetin e secilit prej këtyre grupeve. Zëvendësimi formal i etiketës “magjup” me etiketën “rrom”, për të gjitha këto grupe të marra si një i vetëm jo vetëm nuk e ndërron aspak vëzhgimin dhe trajtimin përbuzës si ndaj rromëve dhe egjiptasve, por mund të çojë në konflikte midis popullsive të ndryshme brenda një kohe relativisht të shkurtër, dhe shenjat e para të këtyre konflikteve po shfaqen tashmë. Paradoksalisht, kjo analizë do të ndeshet edhe me kundërshtimet e disa mbrojtësve të identitetit rrom, të cilët janë të bindur që të dallosh midis popujve që s'kanë gjë të përbashkët veç një etikete profane të vendosur në Mesjetë nga fshatarët bizantinë do të thotë, siç pretendojnë ata, “të përqash për të sunduar”. Atyre do t'u duhet ende kohë për të kuptuar se përkundrazi, përfshirja artificiale e balkano-egjiptasve në të njëtin grup me rromët do t'u priste rrugën të dy grupeve për të afirmuar dhe zhvilluar identitetin e tyre dhe do të ishte zbatim i një formule ende më të rrezikshme: “ngatërron për të sunduar”. Në të vërtetë, të dallosh atë çka është e ndryshme nga pikëpamja historike dhe shkencore nuk është aspak përçarje; përkundrazi, është një metodë e efektshme për të krijuar një kontekst më të shëndoshë i cili do të përbënte një bazë më të fortë për solidaritetin midis shumë grupeve që janë tradicionalistë viktima të racismit – dhe është e qartë që kjo plagë nuk prek vetëm rromët dhe ballkano-egjiptasët.

buletini info

Kontriboni me shkrimet e juaja autentike si:

Opinione
Kulturë
Histori
Shkencë

Dërgoni në email: **buletini.info@gmail.com**